



Përdorimi i statistikave gjinore në hartimin e politikave

Ilda Bozo

Drejtoreshë e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore

Rendesia e statistikave gjinore



- Hartimi i politikave bazuar ne evidenca është një nga kushtet bazë për të patur politika të efektshme në rritjen e mirëqenies së popullsisë
- Politikat për barazinë gjinore kanë si objektiv kryesor mundësimin dhe ofrimin e shanseve të barabarta për femrat dhe meshkujt, për pjesëmarrjen në jetën shoqërore, ekonomike dhe politike të vendit.
- Njohja e situatës së femrave dhe meshkujve në shoqëri, në të gjitha sferat e jetës-orienton politik-bërësit drejt vendimarrjeve të duhura mbi këto politika.

Mjetet



Femra dhe Meshkuj në Shqipëri

- Rekorde administrative
- Survey
- Studime të ndryshme

Anketa e Forcave të Punës

Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës

Anketa e përdorimit të kohës

Anketa për dhunën në familje

Analiza për barazinë gjinore në shumë aspekte të shoqërisë shqiptare

Seti i Treguesve të Harmonizuar Gjimore



- Matja e barazisë gjimore në shumë fusha të jetës si dhe monitorimi i rritjes së pjesëmarrjes së femrave në shoqëri kërkon tregues të besueshëm statistikorë.
- Mbledhja dhe analiza e Treguesve të Harmonizuar mbi Barazinë Gjimore dhe Statusin e Grave në Shqipëri është një mjet i rëndësishëm për pasqyrimin e realitetit, vlerësimin e tendencave të zhvillimit dhe monitorimin e angazhimeve të Qeverisë Shqiptare për barazinë gjimore dhe të drejtat njerëzore të grave.

Treguesit e harmonizuar gjinorë janë kategorizuar sipas 8 drejtimeve kryesore



1. Mekanizmat ligjor dhe institucional
2. Pjesëmarrja në vendimmarrje
3. Fuqizimi ekonomik
4. Qasje e barabartë për një arsim cilësor
5. Shërbime cilësore sociale për gratë dhe vajzat e reja në rrezik
6. Qasja e sistemit shëndetësor ndaj nevojave të veçanta të femrave dhe meshkujve
7. Roli i medias në përparimin e barazisë gjinore në shoqëri
8. Minimizimi i dhunës ndaj grave përfshirë dhunën në familje

Mekanizmat ligjorë dhe institucionale



- Përgjatë viteve ka pasur një rritje të ndjeshme në hartimin dhe miratimin e ligjeve dhe akteve nënligjore për barazinë gjinore, për antidiskriminimin, dhe dhunën në familje.
- Krijimi i mekanizmave institucionale për barazinë gjinore – e nevojshme të forcohen duke rritur kapacitetet njerëzore dhe financiare.
- Është e nevojshme të funksionojnë mekanizmat dhe procedurat përkatëse për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e bashkërenduar në të gjithë sektorët në nivel kombëtar dhe vendor.

Pjesëmarrja në vendimmarrje



- Përmirësim të mbledhjes së statistikave për përfaqsimin e grave në sektorët e : policisë, mbrojtjes, sistemin gjyqësor, qeverisjen qendrore dhe atë vendore.
- Përfaqësimi në Parlament 30 femra – 21%
- Përfaqësimi në qeveri 7 femra – 37%
- Përfaqësimi në nivel zv.min. 9 femra – 39%
- Përfaqësimi në nivel vendor 7,7%
- Mungesë të dhënash - Përfaqësimi i grave në poste drejtuese në kompani private nuk ka nisur ende të diskutohet dhe nuk ekzistojnë të dhëna mbi përfaqësimin e tyre si drejtuese, kryetare kompanish apo anëtare të këshillave drejtues.

Fuqizimi ekonomik



- Gratë - gjysma e popullsisë gjysma e FP në Shqipëri.
- Llojet e punëve , kushtet e punës , mundësia për të ecur përpara në punë
- të ndryshme
- Përgjegjësitë kryesore për punët që lidhen me mbajtjen e familjes dhe shtëpisë
- të ndryshme – njohja e situatës nxjerr në pah vijueshmërinë e roleve tejet të stereotipizuar gjinorë në përdorimin e kohës.
- Plani i Veprimit në Mbështetje të Gruas Sipërmarrëse 2014-2020.
- Njohja e situatës për një qasje të pakët në kredi dhe pronë dhe për pasojë niveli i ulët i grave në sipërmarrje (27%) – hartimi i një politike të re
- VKM nr. 592 datë 10.09.2014 “Për krijimin e Fondit në mbështetje të grave sipërmarrëse” me shtrirje kohore prej 4 vitesh.

Qasje e barabartë për një arsim cilësor



- Arsimi - ngushton hendekun midis grave dhe burrave në përdorimin e mundësive social-ekonomike.
- Sektori shqiptar i arsimit prodhon një mori statistikash mbi arsimin dhe të gjithë treguesit kryesorë janë të ndarë sipas seksit dhe moshës. Në disa fusha, të dhënat janë të ndara edhe më shumë, në bazë të vendbanimit në fshat apo qytet.
- Përmirësimi i mëtejshëm - prejardhja etnike, paaftësia dhe mjedisi social-ekonomik – faktorë që prodhojnë vulnerabilitet. Kjo ka rëndësi sidomos për monitorimin gjinor të qasjes në arsim të vajzave dhe djemve nga grupet e cënueshme.
- Në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga kuadri kombëtar ligjor dhe i politikave, duhet të trajtohet karakteri gjinor i stereotipizuar i arsimit profesional.

Shërbime cilësore sociale për gratë dhe vajzat e reja në rrezik



- Situata sociale në të cilën ndodhen :
- varfëria
- qasja në shërbimet shoqërore.

Në përgjithësi, të dhënat ekzistuese gjinore për varfërinë dhe mbrojtjen shoqërore nuk janë të plota.

- kalimi i NE si përgjegjësi e gruas në familje.
- gratë me AK që mund të jenë nëna të vetme apo kryefamiljare trajtohen me shërbime mbështetëse nga qendrat publike komunitare dhe orientohen te OJF-të që ofrojnë shërbime alternative
- Duhet përgatitur të dhëna gjinore për ofrimin e shërbimeve shoqërore, me qëllim për të monitoruar qasjen e barabartë tek shërbimet, me synim të posaçëm reagimin ndaj nevojave të grupeve të përjashtuara, të mënjanuara dhe të cenueshme dhe në veçanti, të grave dhe vajzave.

Qasja e sistemit shëndetësor ndaj nevojave të veçanta të femrave dhe meshkujve



- Ofrimi i shërbimeve shëndetsore cilësore dhe të mirëtargetuara, kërkon një njohje të mirë të situatës dhe nevojave specifike gjinore.
- Trajtimi i nevojave specifike gjinore dhe pabarazive gjinore në sigurimin e shërbimeve shëndetësore do t'u japë mundësi të gjitha grave dhe të gjithë burrave të gëzojnë jetë më të shëndetshme dhe të kontribuojnë për një barazi më të madhe në të gjitha fushat e jetës.
- Monitorimi i progresit të shëndetit të grave dhe burrave dhe hartimi i politikave shëndetsore gjithëpërfshirëse dhe efektive, do të kërkonte një informacion më të detajuar.
- Të dhëna specifike që lidhen me vulnerabilitetin. (individë Rom, personat me aftësi të kufizuar etj)

Minimizimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje



- Dhuna ndaj grave është një pengesë për arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes.
- Dhuna shkel dhe cenon gëzimin nga gratë, të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore.
- Në Shqipëri dhuna në familje vazhdon të jetë e përhapur në të gjitha shtresat e shoqërisë.
- Anketa për dhunën në familje

- Ngritja e procedurave dhe mekanizmave për harmonizimin në shkallë vendi, për sinkronizimin dhe kanalizimin e të dhënave të mbledhura brenda këtij sistemi. Të dhëna të tilla janë thelbësore edhe në hartimin e masave specifike parandaluese që të synojnë këtë grup.
- Krijimi i sistemit on-line të mbledhjes së të dhënave për rastet e dhunës me bazë gjinore dhe ate në familje.

Të dhëna për Dhunën me bazë gjinore



- Gratë e grup-moshës 18-24 vjec 64%
- Gratë me arsim të ulët 67 %
- Gratë rurale 67%
- Shkalla e pjesëmarrjes së grave në FP
- 15-29 vjec 39%
- 30-64 vjec 66%

Rekomandime

14

- Zbatimi në praktikë i treguesve të harmonizuar gjinorë në të gjithë sektorët
- Përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, analizës dhe interpretimit të të dhënave të ndara sipas seksit dhe përdorimi i tyre për planifikimin dhe politika në nivel qendror dhe vendor.
- Të nevojshme: studime të thelluara (varfërinë, shëndetin, sektorin privat, informalitetin, të drejtat e pronës mbi tokën, dhe gratë rurale.
- I nevojshëm integrimi i objektivave gjinorë në të gjithë sektorët dhe strategjitë ndër-sektoriale, përfshi dhe planet e veprimit.
- Financimi për barazinë gjinore si pjesë e pandashme e politikave
- Alokimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe teknike për zbatimin e politikave gjinore.

Faleminderit!